

**RRETHANAT E PËRGJITHSHME POLITIKE NË PRAG TË SHPALLJES  
SË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË DHE ROLI I AUSTRO-HUNGARISË**

**TEMA PËR TITULL**

**MASTER I HISTORISË NË DEPARTAMENTIN E HISTORISË**

**NGA:**

**FLORENT HASANI**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI FILOZOFIK**

**DEPARTAMENTI I HISTORISË**

**PRISHTINË**

**KORRIK, 2023**

## REZYME PËR TEMËN E DIPLOMËS MASTER

**Mentori:** Prof. Dr. Ibrahim Gashi

**Kandidati:** Florent Hasani

**Tema:** Rrethanat e përgjithshme politike në prag të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe roli i Austro-Hungarisë

Shtirjen gjeografike të popullit shqiptar në trojet e tyre shekullore të Ballkanit Perëndimor, ka herë fuqia e kohës, Austro Hungaria, e kishte shikuar me interes e sidomos në fillim të shek. XX, ku qartazi trevat shqiptare i panë si mundësinë e vetme për të ruajtur status quonë në një Ballkan të ardhshëm pa Perandorinë Osmane. Prandaj ishte Vjena ajo që e mbështeti fuqishëm në të gjitha aspektet krijimin e shtetit shqiptar. Situata e përgjithshme politike në Ballkan ishte e paqëndrueshme dhe e pashpresë për Shqipërinë e atyre muajve, megjithatë që një fat i madh për shqiptarët sepse aspiratat e tyre të kahmotshme për liri e pavarësi, vetëm tani kur përputheshin me interesat austriake dhe italiane, do të mund t'i realizonin.

Kreu I trajton hollësisht rrethanat e përgjithshme politike dhe ushtarake në hapësirat ballkanike të vitit 1912. E përshkruar me përpikmëri është edhe lidhja e Aleancës Ballkanike midis Malit të Zi, Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë dhe objektivat e saj të cilat nuk rezultuan vetëm për dëbimin e Perandorisë Osmane nga Ballkani, por edhe për coptimin e tokave shqiptare. Pas investimeve të kahershme që kishte bërë Vjena për rizgjimin dhe avancimin e popullit shqiptar në shumë drejtime, tani në momentumin e krijuar do të paraqitet edhe qëndrimi zyrtar i saj, pro krijimit të Shqipërisë së pavarur. Do të përshkruhet edhe gjendja tejet e vështirë e hapësirave shqiptare sidomos e atyre kufitare, dhe javët e mundimshme para ditës së mbajtjes së Kuvendit të Vlorës. Në të gjitha këto rrethana, natyrisht Fuqitë e Mëdha që patën interesat e tyre në Ballkan, do të ishin të përfshira duke mbështetur aleatët e tyre. Në këtë rast austriakët dhe italianët në përkrahje të krijimit të shtetit shqiptar, kurse rusët e francezët do të përkrahnin realizimin e objektiveve të aleatëve shovenist të Ballkanit. I përshkruar është edhe qëndrimi neutral i Anglisë, si dhe rreshtimi i Gjermanisë krah interesave austro-hungareze.

Kreu II trajton mbështetjen e Vjenës zyrtare në organizimin e Kuvendit të Vlorës dhe realizimin e aktit final të Shpalljes së Pavarësisë, kjo me qëllim që Aleanca Ballkanike dhe fuqitë që i

mbështesnin qëllimet ekspansioniste të tyre, të gjindeshin para një akti të kryer. Do të paraqitet edhe organizimi i rezistencës ndaj sulmeve të Aleancës Ballkanike, sidomos Beteja e Merdarit në Llap, që ishte edhe përballja e parë frontale shqiptaro-serbe në atë luftë. Të përshkruara janë edhe Beteja e Kumanovës, rezistenca që u organizua për mbrojtjen e Pejës dhe të Shkodrës nga ushtria malazeze, si dhe rezistencat në Epir kundër ushtrive greke. Trajtim specifik do të kenë edhe rrethimi i qyteteve të mëdha, Shkodrës dhe Janinës, dhe rezistenca e gjatë që u bë në këto qytete. Në vazhdim do të përshkruhet organizimi i Kuvendit të Vlorës, delegatët që morrën pjesë, leximi i aktit final dhe në fundit vendimet e këtij kuvendi.

Kreu III konkretisht trajton përkrahjen që Vjena zyrtare i jep Qeverisë së Vlorës në krye me Ismail Qemalin. Trajtohet edhe orientimi politik gjithnjë perëndimor i Qeverisë së Përkohshme të Shqipërisë, duke pëshkruar vazhdimisht edhe faktin që nuk ishte vetëm Vjena që përkrahu formimin e shtetit shqiptar, por edhe Roma. Janë paraqitur edhe probleme të shumta e të ndryshme dhe rivalitete politike që ndodhën pas pavarësisë. Elaburohet edhe rivaliteti austro-italian për dominimin politik e ekonomik në Shqipëri, si dhe shfaqja e mospajtimit dhe e kontradiktave midis Ismail Qemalit dhe Vjenës.

Kreu IV trajton Konferencën e Ambasadorëve në Londër, qëllimin e thirrjes së saj, pjasëmarrësit në të dhe të gjitha vështërsitë e mospajtimeve gjatë zhvillimit të punimeve, si dhe vendimet e saj. Do të përshkruhen polemikat sidomos për caktimin e kufijve dhe debatet e nxehta mes palëve, paraqitja e hartave austro-italiane e ruse dhe vendosja përfundimtare e kufijve në veri e në jug të shtetit shqiptar. Debate të nxehta do të kishte edhe për caktimin e Statusit Final të Shqipërisë, të cilat janë paraqitur në detaje, sidomos kompetencat e KNK-së dhe dakordimi që Shqipëria të ishte një principatë autonome, në krye të së cilës do të vite një personalitet që Fuqitë e Mëdha do ta emëronin princ. Në fund përshkruhet përzgjedhja e Wilhelm Wied si personaliteti i duhur për kororën princërore të Shqipërisë. Do të paraqiten kërkesat e tij për pranimin e fronit, pasataj mbërritja e tij në Shqipëri, formimi i qeverisë nga Wied, dhe largimi i tij nga Shqipëria pas 6 muajve në pushtet.

Për realizimin e këtij punimi, janë bërë studime e hulumtime të shumta, gjithnjë duke përdorur metodat shkencore të historisë si dhe rregullat e shkrimit akademik. Qëllimi thelbësor i punimit është paraqitja në detaje e të gjitha ngjarjeve të rëndësishme që ndodhnin në atë kohë, përshkrimi i rrethanave tejet të vështira ku u gjend populli shqiptar si dhe të gjitha organizimet politike e

ushtarke që ndodhën për realizimin e qëllimit madhor që i bashkonte, pra të formimit të shtetit shqiptar. Përpjekjet e shumta të shqiptarëve më në fund patën fatin të ishin në një vijë me interesat e Austro-Hungarisë por edhe të Italisë të cilat e mbështetën krijimin e shtetit shqiptar, përmes së cilit ato e panë të mundur ruajtjen e statusit quosë në Ballkan dhe rrjedhimisht pengimin e daljes serbo-ruse në ujrat e nxehta.

Përfundimisht mund të themi se shteti shqiptar arriti të merrte formë dhe jetë vetëm me mbështetjen e madhe austro-hungareze. Austro-Hungaria që e ashpër dhe këmbëngulëse në Konferencën e Londrës, ku do të zhvillonte një luftë të vështirë diplomatike me Rusinë e Francën, në veçanti për caktimin përfundimtar të kufijve dhe Statusin Final të Shqipërisë. Shqipëria që u njoh pas Konferencës së Londrës nuk ishte ajo që e kishin ëndërruar të krijonin shqiptarët, jashtë saj mbetën troje e popullsi të shumta shqiptare, megjithatë Shqipëria do të ishte motivi dhe shpresa e atyre që mbetën jashtë kufijve juridik të saj. Në veçanti, Kosova do të ishte krahina shqiptare, e cila asnjëherë nuk i ndali përpjekjet për çlirim dhe bashkim me shtetin amë.

Në fund dua të falenderoj Menorin tim, Prof. Dr. Ibrahim Gashin, për konsultat dhe këshillat e dhëna për punimin dhe finalizimin e këtij projekti.